
**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Split 24” Sh.p.k.**

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Split 24” Sh.p.k.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “Split 24” Sh.p.k. dhe zoterohet nga ortaku:

- 1- Luca Farina**, atesia **Pierangelo**, shtetas italian, lindur me **28/03/1968** ne Itali banues ne **Monza (Itali)**, identifikuar nepermjet kartes se identitetit **CA82754FQ**.
- 2- Piergiorgio Salvatti**, atesia **Giovanni**, shtetas italian, lindur me **11/02/1965** ne Itali banues ne Usmate Velate (MI) (Itali), identifikuar nepermjet kartes se identitetit **AU9736022**

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themeli të shoqërisë “Split 24” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte “Split 24” Sh.p.k.

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionoje në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: TIRANE Njesia Administrative nr 5, Rruga Brigada VIII, Godina nr 23, Hyrja 4, Kodi Postar 1019.Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.



Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4 **KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakeve ose kur ka prishje të hershme për arsyet e parashikuara nga ligji.

NENI 5 **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Shoqëria “Split 24” Sh.p.k. do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

- 1- Organizimi,menaxhimi dhe funksionimi i qendrave te perpunimit te te dhenave kontebel,sherbime back office per llogari te sipermarresve,profesionisteve,kompanive dhe subjekteve te te gjithe llojeve italiane ose te huaja;
- 2- Ofrimi i sherbimeve te organizimit,planifikimit,instalimit,asistence,sherbime furnizimi dhe mirembajtje ne fushen e teknologjive te informacionit dhe sektoreve te lidhur drejtperdrejt;
- 3- Organizimi i kongreseve,takimeve,panaireve,dhe eventeve te ngjashme;
- 4- Perzgjedhje personeli dhe kurse trajnimi;
- 5- Zhvillimi i reklamave dhe ndertimi i faqeve WEB ne internet
- 6- Pjesëmarrja dhe përfaqesimi tregtare nga prodhuesit vendas ose të huaj edhe në ata sektore të krahasueshem me objektin themelor të shoqerisë.
- 7- Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve te ndryshme.
- 8- Pjesëmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojne përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.
- 9- Shoqeria mund edhe të zhvilloje aktivitete shërbimesh, cdo lloj operacioni ose investimi në sektorin pasuri te tundshme, pasuri të patundshme, finanziare, tregtare, leshimin e miratimeve, garanci dhe koncesion të hipotekës, duke formuar, marrë pjesë ose duke u bashkuar në ndonjë formë në shoqëri të tjera duke pasur objektiva te ngjashem, të lidhura ose plotësuese me to.



NENI 6 **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërise është 1000 Leke (njemije), i ndare në 2 (dy)pjese.
Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1.Luca Farina	50%	-	500 LEKE
2.Piergiorgio Salvatti	50%	-	500 LEKE

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne një llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelistë dyte.

NENI 7 **AKTET E SHOQERISE**

Shoqeria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8 **ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të shoqërise do të janë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Si rezultat i ndryshimeve që mund t'i ndodhin kompanisë në të ardhmen dhe rritjes së numrit të ortakeve, tanjore me vone, trupi që mban kapitalin aksionar të kompanisë do t'i referohet termi "Asamblea e Ortakeve". Shoqeria mund te percaktoje me shume se një Administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "**Split 24**" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer.


Përveç organeve të parashikuara më sipër Asambleja e Ortakëve mund të krijoje edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërise për një periudhë 3 (tre) vjeçare është emeruar Znj. **Eriselda Pjetri**, identifikuar nga Karta Identitetit Nr. **I55727046C**

NENI 9 **DISPOZITAT E FUNDIT**

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelin, regjistrimin, funksionimin

AKT THEMELIMI "Split 24" Sh.p.k.

Pag. 4 a 5




dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.


Ky akt themelim është hartuar në 2 (dy) kopje, duke patur secili kopje fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 22.01.2024

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
“Split 24” Sh.p.k.**



Luca Farina



Piergiorgio Salvatti

Pag. 5 a 5

AKT THEMELIMI “Split 24” Sh.p.k.